



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 356, Datë 01.12.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 126, DATË 31.05.2022,
“MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM
TIRANA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2196/2 prot., datë 22.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr.126, datë 31.05.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s ndër të tjera me vendimin nr.126, datë 31.05.2022 ka vendosur që *shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të përcjellë në ERE informacion çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor. Po ashtu shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit, dokumenta që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve.*
- ERE, me shkresën nr. 2195/2 prot., e njoftoi shoqërinë për seancë dëgjimore në datën 06.11.2023, ora 11:00. Në seancën e zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., ndër të tjera i kujtoi shoqërisë kushtet e lëna në vendimin nr. 126/2022.
- Shoqëria në seancën dëgjimore të datës 06.11.2023 të zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., informoi se në lidhje me kushtin e lënë në pikën 2 të

vendimit të bordit të ERE-s, procesi gjyqësor në shkallë të parë ka përfunduar dhe shoqëria e ka fituar atë, por Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka apeluar dhe duke qenë se procedurat gjyqësore zgjasin, nuk kanë informuar pasi nuk kanë një vendim të gjykatës të formës së prerë.

- Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2195/1 prot., datë 08.11.2023 shoqëria depozitoi dokumentacionin përkatës për sa informuar në seancën degjimore.
- Për sa sqaruar dhe depozituar nga shoqëria në lidhje me plotësimin e kushtit të lënë në pikën 2, duke qenë se është ende në procese gjyqësore vlerësohet se shoqëria, të depozitohet në ERE menjëherë nga marrja dijani e një vendimi të formës së prerë, vërtetimin e pastër tatimor ose Vendimin e Gjykatës së Apelit.
- Në lidhje me kushtin e lënë në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s, ku shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit, dokumenta që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2195/1 prot., datë 08.11.2022 ka depozituar kontratat e qirasë me nr. 925 rep., nr. 691 kol., datë 27.10.2017 dhe nr. 961 rep., nr. 713 kol., datë 10.11.2017 ku në nenin 3 të këtyre kontratave është përcaktuar se: *kontrata lidhet për një afat të papërcaktuar dhe ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 2017. Evidentohet se këto kontrata mbajnë datë të hershme, por rezulton se shoqëria nuk i ka depozituar përgjatë procedurës së rinovimit për sa kërkuar nga ERE, në kuadër të plotësimit të kushteve.*
- Me depozitim të këtij informacioni, rezulton se shoqëria aktualisht disponon kontratat e kërkuara në pikën 3, të vendimit të bordit nr. 126/2022, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.
- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 126/2022 ndryshon dhe bëhet:
2. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të depozitohet në ERE, menjëherë nga marrja dijani të një vendimi të formës së prerë, vërtetimin e pastër tatimor ose Vendimin e Gjykatës së Apelit.
2. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 126/2022, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI